

STATUTI I
SHOQERISE TREGTARE
“PAN DI ZUCCHERO” SH.P.K.

Kreu 1

Dizpozita te perjithshme

Neni 1

Sipas kerkesave te ligjit numer 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe atij numer 9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, kriohet shoqeria tregtare “PAN DI ZUCCHERO” Sh.p.k , e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe nenet e ketij statuti.

Neni 2

Ne kete statut termat e meposhtme kane keto kuptime:

Statuti: Statuti i shoqerise me perjegjesi te kufizuar “PAN DI ZUCCHERO” Shpk.

Shoqeria: Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar “PAN DI ZUCCHERO” Shpk.

Ligji Tregtar:Ligji 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Në kuptim të këtij statuti, shprehjet në njëjës përfshijnë ato në shumës dhe anasjelltas me përjashtim të rastit kur sipas konteksit të dispozitës rezulton ndryshe. Përemri vtor “ai” përfshin edhe përemrin vtor “ajo” dhe përemrin vtor “atë”, nënkuftohen të dyja gjinitë me përjashtim te rasteve kur sipas konteksit të dispozitës rezulton ndryshe.

Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që shoqëria i drejton ortakëve sipas këtij statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen se janë kryer në mënyrë të rregullt kur dërgohen ortakëve në adresat e deklaruara prej tyre pranë administratorit të shoqerisë.

Kreu 2

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 3

Sot, me 25.07.2018, une, ortaku themelues, kam krijuar një shoqeri me perjegjesi te kufizuar me emrin PAN DI ZUCCHERO Sh.p.k.

Themelues i shoqerise “PAN DI ZUCCHERO” Shpk eshte:

- Z. Antonio Malafronte, i datelindjes 17.08.1976, i biri Nicola, lindur ne Itali dhe banues ne Via Lungo Sisto, nr 2790, Sabaudia (LT), Italia, i pajisur me pasaporte italiane me nr. YA4914537..

Neni 4

Shoqeria do te kete statutin e një shoqerie me perjegjesi te kufizuar.



Neni 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jetë:

1. Prodhim industrial dhe artizanal, përpunim dhe shitje me shumicë dhe pakicë të të gjitha produkteve të pjekjes, pasta të thata, të freskëta dhe produkte gastronomie, të thata, të mbushura dhe të përpunuara, ëmbëlsira, biskota dhe lloje të tjera të pastave, pica etj.
2. Prodhimi i produkteve te majasë, të ngrira dhe të freskëta.
3. Furnizimin për vete dhe për të tretë të produkteve të gatshme dhe gjysëm të gatshme, të freskëta, të paketuara ose të ngrira, gjithashtu edhe për përpunimin e mëvonshëm industrial ose artizanal.
4. Përpunimi i produkteve ushqimore ne përgjithësi për vete dhe për të tretë.
5. Shitja me pakicë dhe me shumicë i të gjitha produkteve ushqimore në përgjithësi, të freskëta dhe të paketuara.
6. Shitja e pijeve alkoolike dhe jo-alkoolike.
7. Hapja e dyqaneve për shitjen e produkteve ushqimore të veta ose të të tretëve, mbledhja e ushqimeve dhe pijeve, prodhimi dhe shitja edhe me shumicë, për lloje të ndryshme të rosticerisë, gastronomisë dhe të ngjashme, bare snack, tavernë, piceri, mensë etj.
8. Te marre pjese ne interesa dhe aksione te shoqerive tregtare direkt dhe indirekt, deri ne kufirin ku keto pjesemarrje influencoje ne objektin e veprimtarise se shoqerise ose dalin kunder legjislacionit te republikes se Shqiperise.
9. Gjithashtu per te arritur qellimin e objektit te veprimtarise shoqeria mund:
 - a) Te kryeje te gjitha operacionet per pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, operacione industriale, financiare dhe tregtare, te lidhura drejtperdrejtë ose jo me te tilla aktivitete, te marre financime te edo lloji dhe te lere garanci te cdo lloji, per detyrime te veta dhe per detyrime te te treteve, brenda te gjitha detyrimeve ligjore ne republiken e Shqiperise.
 - b) Te marre pjese ne interesa dhe aksione te shoqerive tregtare direkt dhe indirekt, deri ne kufirin ku keto pjesemarrje influencoje ne objektin e veprimtarise se shoqerise ose dalin kunder legjislacionit te republikes se Shqiperise..

Neni 6

Shoqeria e ka seline e saj ne:

Rr. "Hamid Shijaku", Hyrja 1, Pall.42, Apartamenti 1, zyra 2, Njesia Bashkiake nr.9, Tirane.
Ajo mund te cele dhe adresa aktiviteti te tjera te dyta, dege e filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj.

Neni 7

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj pa afat.

Neni 8

Shoqeria ka vulen e saj.

Kreu 3 **Kapitali**

Neni 9

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 10.000.000 (Dhjetemilion) leke dhe perbehet nga 1 kuote. Pjesemarrja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

Z. Antonio Malafronte, i datelindjes 17.08.1976, i biri Nicola, lindur ne Itali dhe banues ne Via Lungo Sisto, nr 2790, Sabaudia (LT), Italia, i pajisur me pasaporte italiane me nr. YA4914537, zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te per gjithshme 10.000.000 leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Te gjitha kuotat e kapitalit themeltar do te shlyhen me afat deri ne 2 vjet. Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre.

Neni 10

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet ose te zvogelohet sipas vendimit te ortakeve.

Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje një ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendime ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit i prek ortaket ne te njeften mase ndaj pjesave te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 11

Ortaku mund te transferoje te treteve kuotat e tij te kapitalit pjeserisht ose teresisht. Transferimi i kuotave tek te tretet do te behet vetem pasi te kete marre vendim asambleja e ortakeve me shumice absolute te votave.

Kuotat e kapitalit mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise.
- b) Shitblerjes.
- c) Trashegimise.
- d) Dhurimit.
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Kreu 4

Organet vendimmarrese dhe drejtuese

Neni 12

Organet te shoqerise do te jene:

- Asambleja e ortakeve.
- Administratori.

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit te organeve drejtuese rregullohet si me poshte.

Asambleja e ortakeve

Neni 13

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor.

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e ortakeve merr vendime sa here e sheh te arsyeshme, por domosdoshmerisht per te miratuar pasqyrat financiare vjetore te shoqerise.

Neni 14

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) Emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore, shperndarjen e fitimeve dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 15

Asambleja e përgjithshme thirret nepermjet një njoftimi me shkresë ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike te ortakeve. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet te permbate vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e përgjithshme nuk eshte thirrur sipas paragrafit te mesiperm te ketij nenii, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht kesaj parregullsie.

Neni 16

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne një shumice te zakonshme, asambleja e përgjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejtë vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e përgjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme, vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 17

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat ($\frac{3}{4}$) e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per:

- a) Ndryshimin e statutit,
- b) Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,
- c) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore
- ç) Shperndarjen e fitimeve,
- d) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumice te votave te ortakeve pjesemarres, per ceshje te tjera si:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) Përcaktimin e shpërblimeve;
- d) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- dh) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- e) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet ne QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Administrimi

Neni 18

Asambleja e pergjithshme emeron një ose me shume persona si administrator te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet, me te drejte riperteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Neni 19

Administratori ka te drejte te perfaqesoj shoqerine ne maredhenie me te tretet per permbushjen e aktivitetit te saj ne perputhje me nenin 5 te ketij statuti.

Organzi Administrativ (administratori) ka te drejte dhe duhet te:

- a) Kryeje me mirebesim të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme e ortakeve e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi;
- b) Përfaqësoje shoqërinë tregtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) Përgatit dhe nënshkruaj pasqyrat financiare vjetore, dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrasë asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- d) Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) Kryej regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) Raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) Kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

f) Marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta.

g) Përfaqesojë apo emërojë përfaqësues në çështje gjyqësore që mund të ketë shoqëria ose në çështje të tjera me palë të treta;

Nese asambleja e përgjithshme emeron me shume se një administrator, ata e administrojnë bashkerisht shoqerine, pervec rasteve kur ne vendimin e emerimit shprehet ndryshe.

Asambleja e përgjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme.

Neni 20

Administrator i shoqerise "PAN DI ZUCCHERO" shpk emerohet:

1. Z. Antonio Malafronte, i datelindjes 17.08.1976, i biri Nicola, lindur ne Itali dhe banues ne Via Lungo Sisto, nr 2790, Sabaudia (LT), Italia, i pajisur me pasaporte italiane me nr. YA4914537. Afati i mandatit te administratorit do te jete 5 vjet nga data e miratimit te ketij statuti.

Kreu 5

Kushtet ekonomike

Neni 21

Shoqeria eshte pronare, disponuese dhe perdoruese e pasurise se saj. Ajo vepron ne regjistrin e prones si cdo person tjeter juridik ne Shqiperi, mund te bleje, te shese, te jape ne perdom, etj.

Neni 22

Ne fund te cdo periudhe ushtrimore hartohen pasqyrat financiare sipas ligjeve ne fuqi. Pasqyrat financiare periodike mujore, tremujore, gjashtemujore miratohen e nenshkuhen nga administratori i shoqerise. Pasqyrat financiare vjetore nenshkuhen nga administratori dhe miratohen nga Asambleja e përgjithshme e Ortakeve.

Neni 23

Viti finanziar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit ne QKB dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

Neni 24

Marredheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete statut do zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne Republiken e Shqiperise. Mosmarreveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykaten shqiptare.

Kreu 6

Dizpozita te vecanta

Prishja – Riorganizimi i Shoqerise

Neni 25

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe, per shkaqet:

- a) Me vendim te Asamblese se Ortakeve per prishjen e shoqerise;
- b) Sipas rasteve te parashikuara nga Ligji Tregtar;
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) Me vendim te gjykates;

Neni 26

Ne rastin e prishjes se shoqerise, Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje ose disa likuidatore.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj punonjesve, shtetit e me pas ndaj te treteve. Ne rastin e teprices se kapitalit te shoqerise me perfundimin e likuidimit, kjo i shperndahet Ortakeve.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 27

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Asamblese se pergjithshme te Ortakeve , ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare”.

Baza ligjore

Neni 28

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare”, Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter ne Republiken e Shqiperise.

Neni 29

Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteteve, zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert palet i drejtohen Gjykates se Republikes se Shqiperise per zgjidhje.

Neni 30


Ky statut u perpilua ne prani te ortakeve te shoqerise duke shprehur vullnetin e tyre te plete e te lire.

Ai u perpilua ne tre kopje me fuqi te barabarta secila, per t'u depozituar ne QKB, per t'u shperndare ne organet kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Tirane me 25.07.2018

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE
“PAN DI ZUCCHERO” SHPK

Antonio MALAFRONTI



Aristoi nō përkthim Erjon Xhinoli

